

KONTRATE

PER

THEMELIMIN E AKTIVITETIT TE

SHOQERISE "POPLOL" SH.P.K.



Ndermjet:

ERVIN MANUSHI, i biri i Hismet dhe i Sanije, lindur me date 14.02.1978 ne Tirane dhe banues ne Tirane ne adresen: Rruga: "Muhamet Gjollasha", Pall.64/7, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, per identitetin e te cilit u sigurova nga dokumenti i tij, Pasaporte me Nr.Personal H80214177C;

ERJON BUSHI, i biri i Ali dhe i Bukurije, lindur me date 31.08.1977 ne Tirane dhe banues ne Tirane ne adresen: Blv. "Bajram Curri", Pall. 1 Maji, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, per identitetin e te cilit u sigurova nga dokumenti i tij, Leternjoftim ID me Nr. Personal H70831126N;

Ortaket rane dakort si me poshte.

Neni 1

Te krijojne nje Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin **"POPLOL" SH.P.K.**

Neni 2

Shoqeria ka statusin e personit juridik dhe vulen e saj. Selia e Shoqerise do te jete ne adresen: Njesia Bashkiake Nr.5, Rruga "Pjeter Bogdani", Vila Nr.32, Tirane.

Neni 3

Veprimtaria e Shoqerise, marredheniet qe lindin nga kjo kontrate si dhe marredheniet e saj me personat e trete juridike e private shqiptare apo te huaj rregullohen sipas dispozitave te kesaj kontrate, te statutit perkates dhe te Ligjit 9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

Shoqeria pergjigjet vetem me pasurine e saj. Shoqeria nuk pergjigjet per detyrimet qe ortaket e saj marrin persiper si persona fizike tej veprimtarise saj. Po keshtu ortaket nuk pergjigjen personalisht per detyrimet e Shoqerise dhe

nuk perballojne personalisht humbjet e Shoqerise tej kontributit te tyre, kuotes se kapitalit te vene nga secili.

Neni 4

Veprimtaria e Shoqerise, emertimi dhe selia e saj te percaktuara ne kete kontrate mund te ndryshojne sipas rregullave te percaktuara nga Statuti e Ligji 9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

Neni 5

Objekti i veprimtarise se Shoqerise do te jete:

"Bar - Kafe - Restorant, Club."

Shoqeria mund te ndermarre pjesemarrjen ne ndermarrje qe kane objekte te perafert ose te lidhur me te sajtin qe funksionojne si ne Shoqeri dhe jashte.

Neni 6

Kapitali themeltar do te vendoset ne Shoqeri nepermjet kontributeve te ortakeve. Vlera e kapitalit themeltar eshte 100.000 (njqind mije) Leke ose 2 (dy) kuota dhe e ndare si vijon:

1. ERVIN MANUSHI, zoteron 1 (nje) kuote ne vlere te pergjithshme 50.000 (pesedhete mije) Leke, qe perfaqesojne 50 % te kuotave te kapitalit themeltar te Shoqerise.


2. ERJON BUSHI, zoteron 1 (nje) kuote ne vlere te pergjithshme 50.000 (pesedhete mije) Leke, qe perfaqesojne 50 % te kuotave te kapitalit themeltar te Shoqerise.

Kapitali themeltar mund te rritet nje ose disa here edhe nepermjet kontributeve ne natyre. Ne rast se kapitali i Shoqerise e tejkalon ate qe nevojitet per realizimin e objektivave te Shoqerise ai mund te reduktohet me vendim te Asamblese se Ortakeve sipas Ligjit 9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare". Kapitali themeltar mund te shtohet dhe me kontributet shtese te paleve sipas Ligjit 9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

Çdo kuote i jep zoteruesit te drejten e nje vote.

Pronesia mbi kuotat do te regjistrohet ne regjistrin e ortakeve qe do te mbahet ne seline e Shoqerise nen pergjegjesine e Administratoreve ("Regjistri i Ortakeve").

Regjistri i Ortakeve do te pasqyroje informacionin e meposhtem: (i) identitetin e cdo Ortaku; (ii) numrin dhe vlerën e kuotave qe i perkasin cdo Ortaku; (iii)



daten e fitimit te pronesis se secilit Ortak mbi kuotat; (iv) adresen apo seline e cdo Ortaku; (v) detaje per cdo peng apo barre te vendosur mbi kuotat.



Neni 7

Jetëgjatesia e Shoqerise eshte mbi 15 vjet pervec ndonje zgjidhje tjeter te parakohshme apo zgjatjes se ketij afati.

Neni 8

Fitimi i realizuar nga Shoqeria, pas shlyerjes se detyrimeve ligjore dhe zbritjes se fondeve te tjera, nenshtrimit te taksave sipas legjislacionit ne fuqi, ndahet ndermjet ortakeve perjestimisht me pjesen qe i takon secilit ne kapitalin themelor te shoqerise.

Neni 9

Organet e shoqerise jane:

- Asambleja e Ortakeve.
- Shoqeria do te administrohet nga dy Administratore, te cilet jane Ervin Manushi dhe Erjon Bushi te cilet do te veprojne me firma te perbashketa apo edhe vec e vec. Mandati i Administratoreve zgjat 5 (pese) vjet. Cdo marreveshje e shoqerise me te tretet kerkon domosdoshmerisht miratimin e njerit prej Administratoreve.
- Komisioni i revizionit ose eksperteve kontabel.

Modalitet e formimit dhe te funksionimit te tyre percaktohen ne Statutin e Shoqerise.

Neni 10

Ortaket detyrohen te ruajne karakterin e fshehte te dokumentacionit te informatave, njohurive dhe te pervojes se shkembyer ose te realizuar ne kuadrin e Shoqerise dhe te marrin te gjitha masat e nevojshme per te shmangur perhapjen e tyre qofte edhe pjesisht. Ortaket pergjigjen per pasojat e demshme te nje shkelje te mundshme te ketij detyrimi, kur kjo shkelje eshte rrjedhim i ndonje veprimi te qellimshem ose nga pakujdesia.

Neni 11

Mosmarreveshjet qe mund te lindin midis ortakeve dhe qe nuk do te zgjidhen me anen e bisedimeve reciproke, do te zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.



Neni 12

Dispozita të hollësishme për Shoqerine përcaktohen në Statutin e saj.


Neni 13

Kjo kontratë u përpilua në katër kopje nga të cilat njëra dorëzohet në zyrën Noterisë Tiranë, një tjetër në Qendren Kombëtare të Biznesit, një kopje në Zyrën e Tatimeve dhe një kopje mbahet në dokumentacionin e Shoqerisë.

ORTAKET THEMELUES

ERVIN MANUSHI

Ervin Manushi



ERJON BUSHI

Erjon Bushi



Tiranë me datë 23.10.2018

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

NR. 200 REP
NR. KOL



V E R T E T I M

Ne Tirane sot date 23.10.2018 (dymije e tetembedhjete), para meje Noteres Publike **ENKELEIDA HOXHA**, Notere e Dhomes se Notereve Tirane, me seli ne Bulevardin: "Bajram Curri", prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, u paraqiten personalisht:

ERVIN MANUSHI, i biri i Hismet dhe i Sanije, lindur me date 14.02.1978 ne Tirane dhe banues ne Tirane ne adresen: Rruga: "Muhamet Gjollesha", Pall.64/7, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, per identitetin e te cilit u sigurova nga dokumenti i tij, Pasaporte me Nr.Personal H80214177C;

ERJON BUSHI, i biri i Ali dhe i Bukurije, lindur me date 31.08.1977 ne Tirane dhe banues ne Tirane ne adresen: Blv. "Bajram Curri", Pall. 1 Maji, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, per identitetin e te cilit u sigurova nga dokumenti i tij, Leternjoftim ID me Nr. Personal H70831126N; te cilet nenshkruan me vullnet te lire dhe te plote Aktin e Themelimit te Shoqerise "**POPLOL**" **SH.P.K.** dhe une Noterja vertetoj sipas ligjit 7928 date 01.06.1994 "Per Noterine".

NOTERE

